

Marrja e pështymës

Marrja e mostrave si pjesë e ekzaminimit për tuberkuloz

ALBANSK

Fakte mbi tuberkulozin

Tuberkulozi është një sëmundje që shkaktohet nga bakteri i tuberkulozit (M. Tuberculosis). Bakteri përhapet përmes ajrit me anë të grimcave të vogla kur një person që ka tuberkuloz aktiv në mushkëri kollitet, teshtin, flet ose qesh.

Personat që thithin me anë të frymëmarrjes këtë ajër mund të marrin brenda edhe bakterin dhe kështu infektohen. Rreth 10% e atyre që infektohen zhvillojnë tuberkuloz aktiv një herë gjatë jetës së tyre. Për të mësuar nëse keni sëmundje aktive të tuberkulozit, duhet të kryeni disa teste. Marrja e pështymës është një prej tyre.

Si kryhet testi? Gjatë testimit, do të merrni me anë të frymëmarrjes ujë të kripur përmes një aparati vaporizues që është i lidhur me oksigjen. Avulli rezultues do të iritojë rrugët e frymëmarrjes në mënyrë që të jetë më e lehtë që të kollitni pështymë nga mushkëritë.

Përgatitja

Mos hani dhe mos pini për një periudhë prej 4 orësh përpara testimit.

Si ngjitet tuberkulozi?



Te një person marrës që merr me anë të frymëmarrjes grimcat që përmbajnë bakterin e tuberkulozit.



Nga një person me tuberkuloz që ka bacilin e tuberkulozit në pështymë. Bakteret përhapen kur personi kollitet, teshtin, qesh, këndon ose flet.



Kafshoni pipëzën dhe mbajini buzët të shtrënguara fort rreth saj. Merrni frymë normalisht përmes gojës. Merrni disa herë frymë thellë herë pas here. Lëngjet e tepërta (kondensimi nga avulli) gëlltiten. Nuk do të përdoret mukoza (pështyma) nga goja.



Kur t'ju duhet të kolliteni, nxirrni vaporizuesin nga goja dhe kollituni fort disa herë.



Pështyni të gjithë mukozen që nxirrni me kollitje direkt në gotën e testimit. Për të shmangur ndotjen e gotës së testimit, gota mbahet nën buzën e poshtme.

Procedurën duhet ta përsëritni disa herë. Ndiqni udhëzimet e dhëna nga personeli. Vendosni kapakun kur testimi të përfundojë. Në fund, lani duart.

Çfarë ndodh më pas?

Rezultatet e testimit do të dalin pas 6 deri 8 javësh. Atëherë do t'ju thërrasin për një takim tjetër. Në bazë të rezultateve të testimit, doktori do të vendosë se çfarë do të ndodhë më pas.